



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

**K.DH.SH.II nr.1032/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë**, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Mulliri Vinkell Group Sh.P.K., me seli në Malishevë, kundër debitorit “Ko Turist” Sh.P.K., me seli në Podujevë rr. “Ilir Konushefci”, nr. 14, me autorizim e përfaqëson I. S., avokat nga Prishtina, me bazë përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2274/22 të dt. 29.05.2023, me datë 21.11.2023, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit “Ko Turist” Sh.P.K, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale ,Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2274/22 të dt. 29.05.2023, VËRTETOHET.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2274/22 të dt. 29.05.2023, ka hedhur si të pasafatshme prapësimin e debitorit “Ko Turist” Sh.P.K., të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimorë P.nr.71/20 të datës 23.12.2020 të Përmbaruesit Privat Ymer Kastrati, me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë debitori “Ko Turist” Sh.P.K., duke kërkuar nga Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë që ta shfuqizoje vendimin e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Prapësimi i debitorit është i pas afatshëm.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim me datën 23.12.2020 ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturat për shumën e detyrimit në vlerën prej 12,998.00€.

Përmbaruesi Privat Ymer Kastrati, ka lejuar përmbarimin me aktvendimin P.nr.71/20 dt.23.12.2020. Ndaj aktvendim debitori ka paraqitur prapësim me datën 12.02.2021, duke theksuar se fatura është prezantuar në kopje dhe nuk ka lëshuar fare kuponin fiskal, dhe kërkon të sqarohet se nuk ka të bëjë me asnjë borxh që ka kreditorit, duke propozuar që të aprovoj prapësimin dhe të anulohet urdhërin përmbarimor.

Ndaj prapësimin e debitorit, kreditori me datën 18.02.2021 ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit duke kundërshtuar si të pamundur në asnjë provë të vlefshme, më propozimin që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe propozimin për përmbarim ta aprovoj në tërësi.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin KPPP.nr.2274/22 dt.29.05.2023 ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.71/20 dt.23.12.2020 të Përmbaruesit Privat Ymer Kastrati, me seli në Prishtinë.

Dhoma e Shkalles e Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 e as neni 183 të LPK, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të neni 194 të LPK.

Sipas dispozitës së neni 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet së: *“Prapësimi duhet të dorëzohet gjykatës brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues”*, ndërsa me dispozitën e neni 73 paragrafi 3, parashihet së: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*.

Në këtë kontekst dhe në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjërisht ka vendosur kur e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, sepse nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës konstatohet se debitori aktvendimin për lejimin e përmbarimit P.nr.71/20 dt.23.12.2020 e ka pranuar me datë 06.01.2021, ndërsa prapësimin ndaj këtij urdhri e ka paraqitur me datën 12.02.2021 përmes postës me numër R. 1461542, gjë që vërtetohet nga vula e postës e vendosur në zarfin drejtuar përmbaruesit, nga del se prapësimi është paraqitur pas afatit ligjor dhe si datë e fundit për paraqitjen e prapësimin ka qenë data 13.01.2021, brenda të cilit afat debitori nuk ka vepruar.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të debitorit nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë, por nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe sepse debitori nuk ka mundur të provojë pretendimet e tij ankimore për afatshmërinë e prapësimin.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e neni 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkalles se Dytë**  
**K.DH.SH.II nr.1032/23, me datë 21.11.2023**

**Gjyqtari**  
**Ramush Bardiqi**